

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TIRANË  
INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT  
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

## **SHPLLJE POZICIONI VAKANT**

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës, shpall procedurën e konkurimit për vendin e lirë të punës për pozicionin:

### **Përgjegjës Sektori, Drejtorja e Kontrollit të Terrenit, Zona II (Kategoria III-a/1).**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; VKB Nr.169 datë 24.12.2021 “Për Organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës; Urdhër Nr.414, datë 06.01.2023 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë:

#### **Kërkesat e posaçme për përzgjedhjen e kandidatëve:**

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së presë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje ;
- Diplomë ( Bachelor + Master Shkencor) ose Diplomë e Nivelit të Dytë, *(për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhësi nga MAS)*;
- Të ketë njohuri të mira të paketës Microsoft Office;
- Zoterimi i nje gjuhe te huaj përben avantazh;
- Të ketë aftësi të mira drejtuese,menaxhuese, raportuese, komunikimi dhe të punës në grup;

#### **Përgjegjësi i Sektorit, Zona II ka për detyrë si më poshtë:**

Përgjegjësi i Sektorit varet nga Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit të Terrenit dhe ka këto detyra:

1. Organizon dhe drejton punën në sektor, programon ngarkesën e punës së sektorit, ndan detyrat për çdo specialist dhe ndjek zbatimin e tyre sipas afateve perkatëse;
2. Mban përgjegjësi të drejtpërdrejtë për realizimin e detyrave të sektorit;
3. Ndjek dhe kontrollon punën për trajtimin efektiv dhe brenda afateve, të praktikave të korrespondencës administrative, të adresuara pranë sektorit;
4. Organizon punën për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim ose dijeni pranë instancave eprore, të planeve të punës, materialeve me karakter informues dhe/ose propozues, informacioneve statistikore;
5. Kontrollon punën e vartësve dhe në rast se vëren mangësi, bën propozimet perkatëse në instancat eprore për marrjen e masave disiplinore;
6. Në përputhje me programin vjetor të punës, përgatit programet mujore në nivel sektori dhe drejton punën për zbatimin rigoroz të tyre;
7. Harton metodika kontrolli për njohjen dhe zbatimin e ligjit nga Drejtoritë Rajonale në përputhje me objektin e veprimtarisë së sektorit;

8. Ndjek drejtpërdrejt ushtrimin e veprimtarisë së inspektimit dhe kontrollit për zbatimin e ligjshmërisë në përputhje me objektin e veprimtarisë së sektorit që mbulon dhe informon eprorin mbi konkluzionet përkatëse;
9. Sipas kualifikimit dhe profilit profesional, mund të kryejë edhe detyra të inspektorit në sektor.

**Dokumentat që aplikanti për Përgjegjës Sektori i Drejtorisë së Kontrollit të Terrenit, Zona II, duhet të paraqesë janë si më poshtë:**

1. CV;
2. Kopje ID;
3. Diplomë (Bachelor + Master Shkencor) ose Diplomë e Nivelit të Dytë, dhe listë notash të noterizuara (*për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhësi nga MAS*);
4. Çertifikatë personale dhe familjare;
5. Librezë pune origjinale;
6. Dëshmi e gjëndjes mjekësore;
7. Dëshmi penaliteti;
8. 2 fotografi;
9. Fotokopje të çertifikatave të kualifikimit;

Dërgimi i dokumentacionit do të bëhet pranë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në adresën : Rr. “Abdi Toptani”, 1001, Tiranë, afati është deri me **datë 21.09.2023 ora 16.30**.